

VENDIM
Nr.389, datë 28.6.2007

**PËR DISA SHITESA E NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.123, DATË 15.3.2001 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR RREGULLAT E PROCESIT TË KLASIFIKIMIT TË
SEKRETIT SHETETËROR, PROCEDURAT, QË PËRDOREN PËR IDENTIFIKIMIN E TIJ,
DHE TË DELEGIMIT TË AUTORITETIT TË KLASIFIKIMIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 9, 25 e 31 të ligjit nr.8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.123, datë 15.3.2001 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto shtesa e ndryshime:

1. Pas pikës 9 të shkronjës “A”, “Për klasifikimin e informacionit”, të kreut I, “Rregullat e procesit të klasifikimit”, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Drejtnesit e ministrave dhe të institucioneve të rivlerësojnë dhe të rishqyrtojnë, në Komisionin e Shqyrtimit të Informacionit të Klasifikuar, të gjitha kategoritë e informacioneve, të cilat janë klasifikuar “Sekret shtetëror”, përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr.8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror””.

2. Pika 5 e kreut III, “Delegimi i autoritetit të klasifikimit”, ndryshohet si më poshtë vijon:

“5. Autoriteti i klasifikimit origjinal, në mbështetje të nenit 4 të ligjit nr.8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”, të ndryshuar, në raste të veçanta dhe pas këshillimit me drejtorin e DSIK-së, mund t’ua delegojë këtë të drejtë, me shkrim, funksionarëve të lartë, brenda institucionit, vetëm për informacionet e klasifikuara “Sekret”, “Konfidencial” dhe “I kufizuar”.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha